



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**  
*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë*  
*Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry*



Agjencia Kosovare e Standardizimit  
Kosovo Standardisation Agency  
Kosovska Agencija za Standardizaciju

Baza ligjore:

- Ligji Nr. 06/L-019 për standardizim;
- Ligji Nr. 06/l-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

## **RREGULLORE E BRENDSHME NR. 01/2019 PËR STANDARDDET E HARMONIZUARA KOSOVARE**

Lista e standardeve të harmonizuara të njohura në Bashkësinë Evropiane (në tekstin e mëtejshmë BE) ndryshojnë herë pas here. Këto lista me standarde të krijuara nga kjo rregullore e brendshme pune paraqesin një “shkrepje fotografike” në një periudhë të caktuar kohore.

Të dy organet: Agjencia Kosovare e Standardizimit dhe Autoriteti Rregulator i Kosovës, duhet të jenë të vetëdijshme se duhet kohë midis përgatitjes së një standardi evropian nga Organizatat Evropiane të Standardizimit dhe njohja e tij si një standard i harmonizuar nga BE.

Lista e krijuar përmes këtij procesi identifikon “Standardet e Harmonizuara Evropiane” në një datë të caktuar, në vend të standardit të botuar së fundmi.

Ndryshe nga anëtarët e plotë të CEN/CENELEC, të cilët janë të detyruar të miratojnë të gjitha standarde publikuara nga CEN/CENELEC, Agjencia Kosovare e Standardizimit (në tekstin e mëtejshmë AKS) do të duhet të ndërmarrë veprime të njëanshme për të identifikuar dhe përditësuar standarde. Rekomandohet që AKS të hetojë nëse ekziston një mjet me të cilin mund të informohen automatikisht për ndryshimet në standarde që ata kanë siguruar për publikim për të thjeshtuar procesin e identifikimit të standardeve që kërkojnë përditësimin.

Nuk rekomandohet që AKS ose Autoritetet Rregullatore të Kosovës të parashikojnë ndryshime në standarde përpala se BE të ketë përditësuar listat e saj të standardeve të harmonizuara. Rekomandohet që për këtë të miratohet një politikë brenda grupit përkatesë të punës për të siguruar mirëkuptim të përbashkët. Faqja e internetit e Komisionit Evropian mundëson abonimin në “RSS feeds” e cila ofron njoftimin për ndryshimin e listave të standardeve të harmonizuara të njoitura në BE.

### **Neni 1** **Qëllimi**

Me këtë rregullore të brendshme përcaktohen veprimet e AKS në përgjigje të kërkesave të autoriteteve kompetente për të identifikuar standartet e harmonizuara evropiane që janë aktuale në Republikën e Kosovës për referencë në zbatimin e rregulloreve të bazuara në legjislacionin e BE. Kjo rregullore plotëson aktet ligjore dhe nënligjore që udhëzojnë autoritetet rregullatore për bashkëpunim me AKS.

### **Neni 2** **Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore mbulon përgjigjen e AKS në lidhje me kërkesën për identifikimin e Standardeve Kosovare të listuara si Standarde të Harmonizuara Kosovare në përputhje me dispozitat e ligjeve të mësipërme.

Qëllimi i rregullores është të mundësojë AKS të ofrojë këshilla të qëndrueshme, të sakta dhe në kohë për miratimin dhe statusin e standardeve të harmonizuara evropiane në Kosovë.

Ajo nuk e përjashton organet rregullatore nga përgjegjësia për të siguruar që standartet janë të përshtatshme për aplikim në Kosovë.

### **Neni 3** **Përgjegjësité**

Menaxhmenti i AKS është përgjegjës për sigurimin e zbatimit korrekt të kësaj rregullore të brendshme pune. Stafi i AKS duhet të ndjek këtë rregullore pune në përgjigje ndaj kërkesave për identifikimin e standardeve të harmonizuara.

Duhet të regjistrohet çdo ndryshim në praktikat që rrjedhin nga ndryshimet në politikat e jashtme dhe kjo rregullore pune rishikohet dhe ndryshohet sipas nevojës. Ngjashëm, me identifikimin e mënyrës më efikase të punës, nga, për shembull, qasja në bazën e të dhënavë të CEN/CENELEC, rregullorja e punës duhet të rishikohet dhe ndryshohet për të pasqyruar praktikat më të mira në zhvillim.

## Neni 4

### Procedurat

#### **4.1 Pas pranimit të kërkesës**

Me pranimin e një kërkeze për standarde, AKS për t'u dhënë autoritetet e kompetente detaje për statusin e standardeve të miratuar në Kosovë, duhet të ndërmerr veprimet e mëposhtme:

- a) Regjistrohet data dhe detajet e marrjes së kërkesës;
- b) Kërkesa kalon te zyrtari kompetent i AKS i caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm për të përgatitur një përgjigje ndaj kërkesës në emër të AKS;
- c) AKS e informon palën në bazë të kërkesës dhe i jep përgjigje për kohën e parashikuar.
  - 1) Koha e parashikuar duhet të pasqyrojë kohën e nevojshme për të kryer me saktësi detyrën e duhur. Koha e parashikuar duhet të marrë në konsideratë volumin e standardeve të listuara si standarde të harmonizuara evropiane - duke pasur parasysh se për disa fusha (p.sh. produktet ndërtimore, elektrike apo makineria) të legjislacionit ekzistojnë një numër shumë më i madh i standardeve të referuara si standarde të harmonizuara.
  - 2) Nëse afatet kohore të AKS dhe Autoritetit Rregulator që bënë kërkesë për standarde nuk përputhen, atëherë zyrtari përgjegjës në AKS e njofton menaxhmentin e AKS para se t'i përgjigjet palës.

Kërkesa nga Autoriteti Rregulator duhet t'i ofrohet AKS sa më herët që të jetë e mundur për t'i lejuar AKS kohë të mjaftueshme për të miratuar standarde e kérkuara.

Kërkesa duhet të ketë datë dhe të ofrohen detajet e legjislacionit të BE për miratim si dhe afatet kohore për miratimin dhe zbatimin e rregullores së Kosovës. Nëse këto detaje nuk janë dhënë në kërkesë, AKS do të kérkon këtë informacion.

#### **4.2 Procesi i AKS për të identifikuar standarde e harmonizuara**

Zyrtari përgjegjës në AKS duhet të plotësojë informacionin në tabelën e paraqitur në Aneksin A, me informacionin në lidhje me miratimin e standardeve kosovare të barasvlershme me standarde e harmonizuara evropiane duke aplikuar procesin e mëposhtëm.

##### **4.2.1 Identifikimi i standardeve të harmonizuara evropiane**

Lista e standardeve të harmonizuara kundrejt legjislacionit të BE përcaktohet nga publikimi në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Për lehtësi, Komisioni Evropian ofron një listë të standardeve referuese në faqen e tyre të internetit. Në identifikimin e standardeve përkatëse, AKS do të përdorë tekstin nga GZBE (Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian), të cilil i referohet Komisioni Evropian (Shih Aneksi C). Kolonat 4 dhe 5 në tabelë duhet të plotësohen duke përdorur të dhënat nga tabela e GZBE (shih shembullin në Aneksin B).

#### **4.2.2 Identifikimi i standardeve të harmonizuara kosovare**

Standardet Kosovare që adoptojnë standardet e harmonizuara evropiane identifikohen nga baza e të dhënavë (SMIS) e AKS duke kërkuar standardet specifike (shih Aneksin D). Emërtimi dhe titulli duhet të kopjohen në kolonat 2 dhe 3 të tabelës.

#### **4.2.3 Harmonizimi ndërmjet standardeve kosovare dhe evropiane**

Zyrtari përgjegjës i AKS duhet të plotëson kolonën 3a të tabelës që tregon harmonizim në mes të standardeve kosovare dhe standardeve evropiane.

Termat e mëposhtëm që do të përdoren, kanë këtë kuptim:

1. I harmonizuar: Nëse standardi kosovar është plotësish i harmonizuar me standardin evropian duke përfshirë miratimin e të gjitha ndryshimeve dhe korrigjimeve. Një shembull i kësaj është paraqitur në rreshtin 4 të tabelës së paraqitur në Aneksin A.
2. I pa harmonizuar: Nëse një standard kosovar është miratuar, por nuk është plotësish në përputhje me standardin aktual evropian. Kjo në përgjithësi tregohet nga një ndryshim në datat ose ndryshimet e listuara. Një shembull i kësaj është paraqitur në rreshtin 7 të tabelës së paraqitur në Aneksin A.

Nuk është miratuar: Një standard kosovar ekuivalent me standardin evropian nuk është miratuar.

#### **4.2.4 Veprimet që duhen ndërmarrë**

Zyrtari përgjegjës i AKS duhet të informon menaxhmentin e AKS për veprimet që ndërmerrën për të harmonizuar standardet kosovare me standarde e harmonizuara evropiane. Veprimet e duhura për të harmonizuar standardet përfshijnë:

- 1) Miratimin e ndryshimeve apo korrigjimeve të nevojshme për të përfunduar harmonizimin (si në shembullin, reshti 7 në tabelën e Anekshit B).
- 2) Miratimin e një standardi evropian të rishikuar për të zëvendësuar një standard ekzistues kosovar.
- 3) Miratimin e një standardi të ri evropian për të zëvendësuar një standard ekzistues.
- 4) Rastin kur asnjë veprim nuk është i mundshëm (p.sh. AKS nuk ka qasje në standarde duhura).

Zyrtari përgjegjës në AKS, me menaxhmentin e AKS, duhet të identifikon afatin kohor në të cilin mund të ndërmerrën veprime dhe të siguron që ai të përshtatet me afatin kohor për zbatimin e rregullores. Kolona 3a e tabelës do të ndryshohet për të treguar veprimet që duhen ndërmarrë.

### **4.3 Kontrollimi përfundimtar**

Para se AKS të nxjerrë tabelën në përgjigje të kérkesës, zyrtari përgjegjës i AKS verifikon nëse BE ka përditësuar listën e standardeve të harmonizuara që nga marrja e kérkesës (Aneksi C).

## **Neni 5**

### **Rezultatet**

Lista e standardeve të harmonizuara evropiane kundrejt standardeve kosovare, identifikojnë:

- Standardet e miratuara kosovare të cilat janë plotësisht në përputhje me standardet e harmonizuara evropiane.
- Harmonizimi i standardeve evropiane është veprim i nevojshëm për harmonizimin e plotë të standardeve kosovare.
- Standardet evropiane për të cilat nuk është i mundur asnjë veprim (p.sh. standardet EN që janë identike me standardet ISO/IEC).

**ANEKSI A: Tabela me listën e standardeve të harmonizuara nga AKS**

<b>Lista e Standardeve të Harmonizuara Evropiane dhe Standardeve të Harmonizuara Kosovare ndaj Rregullores</b>					
<b><u>Numri/viti</u><sup>1</sup> në <u>Titull</u><sup>2</sup> (ekuivalent me <u>Direktivën/Rregulloren e BE</u><sup>3</sup>). <u>Data e lëshimit</u><sup>4</sup></b>					
1	2	3	3a	4	5
	<b>Standard i Harmonizuar Kosovar</b>			<b>Standardi i Harmonizuar Evropian, ashtu siç është listuar në GZBE<sup>5</sup></b>	
Nr.	Standardi i harmonizuar kosovar	Titulli i standardit në shqip	Harmonizimi /Veprimi	Titulli i standardit në anglisht	Standard i harmonizuar evropian Referencia <sup>6</sup>

<sup>1</sup> p.sh. 03/2017

<sup>2</sup> p.sh. Siguria e ashensorëve

<sup>3</sup> p.sh. Direktiva (2014/33/BE)

<sup>4</sup> Data e përfundimit të tabelës nga stafi i AKS

<sup>5</sup> p.sh. (GZBE (2016/C 293/05) 12.8.2016)

<sup>6</sup> Siç është botuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian...

**ANEKSI B: Shembull i një liste të kompletuar të tabelës së standardeve të harmonizuara**

<b>Lista e Standardeve të Harmonizuara Evropiane dhe Standardeve të Harmonizuara Kosovare ndaj Rregullores së MTI 03/2017 mbi sigurinë e ashensorëve (ekuivalent me Direktivën e BE (2014/33/BE) <u>14 nëntor 2018</u></b>					
1	2	3	3a	4	5
<b>Standard i Harmonizuar Kosovar</b>				<b>Standardi i Harmonizuar Evropian siç është listuar në (GZBE, 2016/C 293/05) 12.8.2016</b>	
Nr.	<b>Standardi i harmonizuar kosovar</b>	<b>Titulli i standardit në shqip</b>	<b>Harmonizimi/ Veprimi</b>	<b>Titulli i standartit në anglisht</b>	<b>Standardi i harmonizuar evropian (Referenca)</b>
1.	SK EN 81-20:2019	Rregullat e sigurisë për ndërtimin dhe instalimin e ashensorëve- Ashensorë për transportin e njerëzve dhe të mallrave-Pjesa 20: Ashensorë pasagjerësh për mallra dhe pasagjerë	Është miratuar	Safety rules for the construction of instalation of lifts- Lifts for the transport of persons and goods-Part 20: Passenger and goods passenger lifts	EN 81-20:2014



Numri dhe titulli nga të dhënat e AKS  
(Aneksi D)

Detajet e kopjuara nga listat e GZBE  
(Aneksi C)

Harmonizimi midis standardeve SK dhe  
EN

#### **ANEKSI C: Identifikimi i Standardeve të Harmonizuara Evropiane**

Listat e standardeve të publikuara nga Komisioni Evropian mund të merren nga URL  
[https://ec.europa.eu/growth/single-market/european-standards/harmonised-standards\\_en](https://ec.europa.eu/growth/single-market/european-standards/harmonised-standards_en)<sup>7</sup>

---

<sup>7</sup> Qasur me 12 Nëntor 2018

## Harmonised Standards - Growth - European Commission

2-3 minutes

A harmonised standard is a European standard developed by a recognised European Standards Organisation (CEN, CENELEC, or ETSI). It is created following a request from the European Commission to one of these organisations. Manufacturers, other economic operators, or conformity assessment bodies can use harmonised standards to demonstrate that products, services, or processes comply with relevant EU legislation.

The references of harmonised standards must be published in the Official Journal of the European Union. The purpose of this website is to provide access to the latest lists of references of harmonised standards and other European standards published in the Official Journal of the European Union (OJEU).

### References of harmonised standards and of other European standards published in the OJEU

#### Accessibility

- [Websites and mobile applications of public sector bodies](#)

#### Chemicals

- [Chemical substances \(REACH\)](#)
- [Explosives for civil uses](#)
- [Pesticides articles](#)

#### Conformity assessment and management systems

- [New Legislative Framework \(NLF\) and Eco-Management and Audit Scheme \(EMAS\)](#)

#### Construction

- [Construction products \(CPD-CPR\)](#)

#### Consumers and workers protection

- [Cosmetics products](#)
- [General product safety](#)
- [Personal protective equipment \(PPE\)](#)
- [Toys safety](#)

#### Energy efficiency

- [EcoDesign and energy labelling](#)

#### Electric and electronic engineering

- [Electromagnetic compatibility \(EMC\)](#)
- [Equipment for explosive atmospheres \(ATEX\)](#)
- [Low Voltage \(LVD\)](#)
- [Radio Equipment \(RED\)](#)
- [Restriction of the use of certain hazardous substances \(RoHS\)](#)

#### Healthcare engineering

- [Active Implantable medical devices](#)
- [In vitro diagnostic medical devices](#)
- [Medical devices \(MDD\)](#)

#### Measuring technology

- [Measuring instruments \(MD\)](#)
- [Non-automatic weighing Instruments \(NAWI\)](#)

#### Mechanical engineering and means of transport

- [Cableways: installations designed to carry persons](#)
- [Equipment for explosive atmospheres \(ATEX\)](#)
- [Gas appliances \(GAR\)](#)
- [Inspection of pesticide application equipment](#)
- [Lifts](#)
- [Machinery \(MD\)](#)
- [Pressure equipment \(PED\)](#)
- [Rail system: Interoperability](#)

Listat e standardeve mund të arrihen nëpërmjet hiperlinqeve (p.sh. për ashensorët).



Listat e Standardeve të Harmonizuara konform direktivave/rregulloreve specifike mund të arrihen duke klikuar:

[https://ec.europa.eu/growth/single-market/european-standards/harmonised-standards/lifts\\_en<sup>8</sup>](https://ec.europa.eu/growth/single-market/european-standards/harmonised-standards/lifts_en)

The screenshot shows the European Commission's website for the Internal Market, Industry, Entrepreneurship and SMEs. The main navigation bar includes links for Single Market and Standards, Industry, Entrepreneurship and SMEs, Access to Finance for SMEs, and Sector. On the left, there is a sidebar with links for Standardisation Policy, Harmonized Standards, Formal objections, Notification System, Standardization requests, Key players, Standardization and SMEs, and Information on European standardization. The main content area is titled 'Lifts' and contains information about Directive 2014/32/EU, including its base (Directive 2009/136/EC), modifications, and commission contact points. Below this is a section for 'Publications in the Official Journal', which lists the publication of references of harmonized standards on lifts and safety components for the Directive 2014/32/EU. At the bottom, there is a summary list of titles and references of harmonized standards under Directive 2014/32/EU for lifts.

EGO	Reference and title of the standard (and reference document)	Date of publication of the standard	Reference of harmonized standard	Date of assessment of conformity of harmonized standard (HSC)
EN	EN 81-00:2014 Safety rules for the construction and installation of lifts for the transport of persons and goods - Part 00: passenger and goods passenger lifts	20/04/2016	EN 81-0 1998+A2:2009 EN 81-0 1998+A2:2009 HSC 2014	31/08/2017
EN	EN 81-01:2009+A1:2012	20/04/2016		

Faqja në GZBE mund të arrihet duke klikuar hiperlinkun (ose listat "pdf" në gjuhë të ndryshme) duke siguruar që është përdorur lista e standardeve për legjisacionin aktual.

<sup>8</sup> Qasur me 14 nëntor 2018

[https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=uriserv:OJ.C\\_.2016.293.01.0064.01.ENG<sup>9</sup>](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=uriserv:OJ.C_.2016.293.01.0064.01.ENG)

C 293/04

EN

Official Journal of the European Union

12.8.2016

Commission communication in the framework of the implementation of Directive 2014/33/EU of the European Parliament and of the Council on the harmonisation of the laws of the Member States relating to lifts and safety components for lifts

(Publication of titles and references of harmonized standards under Union harmonization legislation)

(Text with EEA relevance)

(2016/C 293/05)

ESO <sup>(1)</sup>	Reference and title of the standard (and reference document)	First publication <sup>(2)</sup>	Reference of superseded standard	Date of cessation of presumption of conformity of superseded standard Note 1
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)
CEN	EN 81-20:2014 Safety rules for the construction and installation of lifts — Lifts for the transport of persons and goods — Part 20: Passenger and goods passenger lifts	20.4.2016	EN 81-1:1998 +A1:2009 EN 81-2:1998 +A1:2009 Note 2.1	31.8.2017
CEN	EN 81-21:2009+A1:2012 Safety rules for the construction and installation of lifts — Lifts for the transport of persons and goods — Part 21: New passenger and goods passenger lifts in existing building	20.4.2016		
CEN	EN 81-22:2014 Safety rules for the construction and installation of lifts — Lifts for the transport of persons and goods — Part 22: Electric lifts with inclined path	20.4.2016		
CEN	EN 81-28:2003 Safety rules for the construction and installation of lifts — Lifts for the transport of persons and goods — Part 28: Remote alarm on passenger and goods passenger lifts	20.4.2016		
CEN	EN 81-50:2014 Safety rules for the construction and installation of lifts — Examinations and tests — Part 50: Design rules, calculations, examinations and tests of lift components	20.4.2016	EN 81-1:1998 +A1:2009 EN 81-2:1998 +A1:2009 Note 2.1	31.8.2017
CEN	EN 81-58:2003 Safety rules for the construction and installation of lifts — Examination and tests — Part 58: Landing doors fire resistance test	20.4.2016		

<sup>9</sup> Qasur me 12 Nëntor 2018

#### **ANEKSI D: Identifikimi i standardeve kosovare**

Një kërkim sipas numrit të standardit në të dhënat e AKS identifikon standarde ekuivalente. Si shembull-një kërkim në bazën e të dhënavë SMIS për “EN 81-28” identifikon standardin e mëposhtëm. Numri dhe titulli duhet të kopjohen në kolonat 3 dhe 4 të tabelës.

##### **SK EN 81-28:2012 (en) (Endorsment)**

17 faqe KT-10

Rregulla të sigurisë për ndërtimin dhe montimin e ashensorëve -Ashensorët për transportimin e njerëzve dhe të mallrave -Pjesa 28 : Alarmet e telekomanduara në distancë për ashensorët për transportimin e njerëzve dhe të mallrave (EN 81-28:2003, IDT)

Safety rules for the construction and installation of lifts - Lifts for the transport of persons and goods - Part 28: Remote alarm on passenger and goods passenger lifts

#### **Neni 6 Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore e brendshme për standarde harmonizuara hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm i AKS.



Hafiz Gara  
Drejtor i Përgjithshëm i AKS

Prishtinë,  
19.04.2019